



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.13
Janar
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

01 16 JANAR 2025 ZGJEDHIM TË DREJTIN E VITIT

■ Një nisëm e Fondacionit ZKM që synon të promovojë mes studentëve, operatorëve dhe mysafirëve dimensionin shpirtëror të jetës, qytetarinë aktive, ndjeshmërinë ndaj të mirës së përbashkët.

Në datën 16 janar 2025 në Kampusin Universitar dhe Spitalor Zoja e Këshillit të Mirë dhe në Poliambulancën At Luigji Monti në Rrugën e Kavajës në Tiranë do të zhvillohet për herë të parë një votim i fshehtë dhe gjithëpërfshirës për të zgjedhur "Të Drejtin e viti 2025". Emri i personit më të votuar do të vendoset në datë 6 Mars 2025 në një nga gurët e dedikuar të "Kopshtit të të Drejtëve" që ndodhet në oborrin e Kampusit Universitar ZKM. "Kopshti i të Drejtëve" u çel për herë të parë në Shqipëri një vit më parë si iniciativë e Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë dhe çdo 6 Mars që është Dita Ndërkombëtare e të Drejtëve shpallet një emër i ri.

16 GENNAIO
ELEZIONI
per il GIUSTO
2025
Save the date!

16 JANAR
ZGJEDHJET
per të DREJTIN 2025



Këtë vit janë propozuar 5 kandidatura nga të cilat do të përzgjidhet një prej tyre. Emri fitues do të dalë nga votimi i fshehtë që organizohet në 16 janar 2025. Gjithkush që në datë 16 janar 2025 do të jetë në Universitetin dhe Spitalin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", në Poliambulancën e Rrugës së Kavajës apo në sallat e kampusit universitar është i ftuar të shprehë me votë vendimin e tij se cili duhet të jetë "I Drejti" i vitit 2025. Ky proces do të kryhet në katër qendra votimi që do të vendosen në Casa Rosa, në godinën e Spitalit Katolik, në Poliambulancën At Luigji Monti dhe në godinën qendrore të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Deri në datën 16 janar 2025 do të shpërndahen fletët informuese për jetën dhe veprën e 5 kandidatëve dhe fletët e votimit që pasi të jenë shënuar nga votuesit do të hidhen në kutitë e vendosura në 4 qendrat e votimit të treguara si më sipër.

CILËT JANË KANDIDATËT PËR VITIN 2025?



I Giovani della ROSA BIANCA

Anëtarët e **“Trëndafilin të Bardhë”** ishin studentë të rinj katolikë, protestantë dhe ortodoksë në të njëzetat e tyre. Atyre iu bashkua profesori universitar Kurt Huber. Në foto shihni Hans Scholl, motrën e tij Sophie dhe Christoph Probst. Pjesë e grupit ishin edhe Alexander Schmorell dhe Willi Graf. Së bashku ata organizuan një sistem klandestin përmes të cilit përpiqeshin të sabotonin rregjimin e Hitlerit. Në veçanti ata iu përkushtuan shtypjes dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve përmes të cilave nxisnin bashkatdhetarët e tyre që në emër **të lirisë dhe vëllazërisë mes popujve** të rebeloheshin dhe t'i rezistonin nacional-socializmit. Pas publikimit të fletëpalosjes së parë të qershorit 1942 pati dhe pesë të tjera, deri më 18 shkurt 1943. Vëllezërit Scholl u zbuluan dhe arrestuan në Universitetin e Mynihut. Më pas edhe anëtarët e tjerë u arrestuan nga Gestapo, u gjykuan dhe u dënuan me prerje koke. Para ekzekutimit Sophie tha: **“Një ditë kaq e bukur me diell dhe unë duhet të iki...Nuk ka rëndësi nëse vdesim nëse veprimet tona kanë shërbyer për të shkundur dhe zgjuar ndërgjegjen.”**



Adriano Olivetti

Adriano Olivetti lindi në vitin 1901 në një familje hebreje. Pasi u diplomua për kimi industriale ai punoi në kompaninë e babait të tij. Olivetti zgjodhi të punonte si të gjithë të tjerët në sipërmarrjen e familjes, për të kuptuar vështirësitë dhe nevojat e tyre. Kompania e cila prodhonte makina shkrimi dhe produkte mekanike u njoh në tregun ndërkombëtar, madje hodhi disa

hapa drejt teknologjisë elektronike, duke prezantuar **në vitin 1959 makinën e parë llogaritëse elektronike në treg, të cilësuar si ‘gjyshin’ e kompjuterit.** Pasi u bë president i kompanisë Adriano shumëfishoi shërbimet dhe iniciativat për punonjësit dhe familjarët e tyre, **duke përfshirë kujdesin shëndetësor, sigurimet, çerdhet dhe kampet verore për fëmijë, komplekset rezidenciale, bibliotekat dhe qendrat rekreative për familjet.**

Atmosfera e bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet drejtuesve dhe punëtorëve që mbizotëronte në fabrikat e tij ishte një element i rëndësishëm i suksesit të kompanisë. **Adriano Olivetti** nuk ishte vetëm sipërmarrës, por ishte gjithashtu planifikues urban, shkrimtar, botues dhe mbi të gjitha reformator social që fokusohej tek krijimi i komunitetit. Olivetti, i cili më vonë iu bashkua besimit katolik, i kujtonte vetes dhe ndonjëherë edhe punëtorëve të tij **se duhet të kërkojnë më parë Mbretërinë dhe drejtësinë e Zotit dhe të gjitha gjërat e tjera do t’ju jepen.** Ai vdiq në vitin 1960.



Cicely Saunders

Cicely (1918–2005) vjen nga një familje e pasur, por ajo e nivelit të lartë, e cila la studimet e ekonomisë për t’u bërë infermiere. Ajo krijoi në vitin 1967 bujtinën e parë moderne dhe shpiku **kujdesin paliativ** duke revolucionarizuar në këtë mënyrë historinë e mjekësisë dhe kujdesit shëndetësor. Bujtina e kujdesit të posaçëm është një vend në të cilin pacienti terminal jeton me dinjitet, pavarësisht vështirësive.

Edhe kur sëmundja është e pashërueshme trajtimi vazhdon, vuajtjet mund të qetësohen dhe gjendjes shpirtërore të tij i kushtohet e njëjta vëmendje si ajo që i kushtohet trupit. Në bujtinë nuk shërohet, por nuk je kurrë vetëm. **Në vitin 1981 ajo mori çmimin “Templeton” dhe ende sot Organizata Botërore e Shëndetësisë** i njej përpejket e saj si standarde themelore të kujdesit shëndetësor. Jeta e saj shpirtërore e bëri atë të konvertohej nga ateiste në të krishterë në Kishën Ungjillore.

Ajo thoshte: **Mjeku dhe personeli duhet të rrezikojnë gjithçka,** duke ndarë së bashku me pacientët humanitetin, duke kërkuar kuptimin e jetës dhe duke ecur së bashku drejt **shpresës dhe përtej shpresës”.**



Antonio Megalizzi

Antonio Megalizzi lindi në vitin 1989 dhe u diplomua në Shkenca Komunikimi. Djaloshi ndoqi programin e Masterit në Studime Evropiane dhe Ndërkombëtare në Universitetin e Trentos, ndërsa në vitin 2015 ai ndoqi shkollën verore në Bruksel, e cila i hapi një dimension të ri të zhvillimit personal. Antonio dalloi hendekun e komunikimit mes institucioneve evropiane dhe qytetarëve, ndaj krijoi programe gazetareske për të shpjeguar dhe afruar **Bashkimin Evropian** tek njerëzit. Ndërsa rritej profesionalisht si spiker dhe gazetar në radio, ai u bë pjesë e ekipit redaktues italian të formatit të radiove universitare evropiane 'Europhonica', për të zhvilluar një qytetërim evropian të ndërgjegjshëm.

Në katër vite ai krijoi mbi 100 programe radiofonike në BE dhe trajnoi dhjetra të rinj, duke bërë pjesë të programit edhe eurodeputetët e Parlamentit Evropian. Antonio u vra në moshën 29 vjeçare në sulmin terrorist të 11 dhjetorit 2018 në Strasburg, në zemër të Bashkimit Evropian. Në emër të tij u krijua **Fondacioni "Antonio Megalizzi"**, me synimin për të promovuar, koordinuar, organizuar dhe mbështetur iniciativat dhe ngjarjet që çojnë përpara ëndrrën evropiane të Antonios. Miqtë e tij tregojnë se Antonio kishte një det ëndrrash dhe vendosmëri për t'i realizuar të gjitha ato. Antonio ishte empatia, aftësia **për të kuptuar vuajtjet e të tjerëve**. Ai ishte burim frymëzimi sepse këmbëngulte për të përfunduar punën e tij me përlësi dhe pa u lëkundur. Ai rrezatonte, siç kujtojnë miqtë e tij, forcën për të kërkuar gjithmonë maksimumin nga vetja".



Ibrahim Rugova

Ibrahim Rugova, ish- President i Republikës së Kosovës (1944-2006). Ai u zgjodh kryetar i Partisë "Lidhja Demokratike e Kosovës" (LDK) në vitin 1989. Me përpjekjet e tij iu kushtua arritjes së pavarësisë së Kosovës në mënyrë paqësore, duke krijuar një lloj "qeverie në hije" të krahinës që para viteve '90 ishte pjesë e Federatës Jugosllave. Administrimi i Kosovës në këtë periudhë siguroi ngritjen e shkollave dhe spitaleve, të cilat u mbështetën tek kontributi i shqiptarëve që jetonin jashtë territorit. Rugova mbështeti rrugën paqësore edhe për të ndalur gjakmarrjen, një zakon shoqëror të rrënjosur thellë në këtë shoqëri.

Pas vetëshpalljes **së Kosovës Republikë** në vitin 1992 nëpërmjet referendumit, Rugova u bë president i saj i parë. Gjatë luftës së viteve 1998-1999 për çlirimin e Kosovës ai ishte një pikë e rëndësishme referimi politik dhe ndërkombëtar edhe për qeveritë perëndimore. **Në vitin 2001 ai u shpall presidenti i parë i Kosovës së lirë dhe të pavarur**. Rezistenca me durim dhe përkushtim paqësor ndaj regjimit serb të Sllobodan Millosheviçit e frymëzoi veprimtarinë e tij politike gjatë gjithë krizës së vështirë kosovare, të fundviteve '90 dhe mesit të viteve 2000. Për këto arsye ai u quajt si **"Gandi kosovar"**. Ai ndërroi jetë në janar të vitit 2006.

RREGULLORE

1. Kopshti i të Drejtëve pranë Fondacionit "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë (Shqipëri) promovon çdo vit zgjedhjen e një ose më shumë të Drejtëve në një datë të caktuar, nëpërmjet përfshirjes së personave të pranishëm në Kompleksin universitar-spitalor.

2. Presidenti i Fondacionit emëron një Grup operativ për të koordinuar përgatitjen dhe zbatimin e këtij event vjetor.

3. Ky grup kryen funksionet e mëposhtme:

a. propozon brenda muajit nëntor **një listë figurash që do të jenë kandidatë** për t'u zgjedhur, shoqëruar me një profil të shkurtër biografik për secilin prej tyre. Në fillim të muajit janarit publikohet një broshurë përshkruese e figurave të përzgjedhura për të kandiduar.

b. përfshin Studentët e Grupit universitar "Qendra Burimore për EkologjinëIntegrale" (CREI) për organizimin e këtij aktiviteti

c. përcakton një datë në muajin janar për zgjedhjen e një apo më shumë të Drejtëve nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve, punonjësve të Fondacionit dhe të personave të pranishëm në Kompleksin universitar-spitalor ZKM

d. publikon brenda fundit të muajit janar **rezultatit e zgjedhje**

4. Më **datë 6 mars** që është Dita evropiane e të Drejtëve zbulohet guri i Kopshtit në të cilin është gdhendur emri i të Drejtit apo të Drejtëve të vitit.

Domethënia e Kopshtit

Kopshtet e të Drejtëve u krijuan për të nderuar gratë dhe burrat që përballë ngjarjeve të mëdha marrin përgjegjësinë personale për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe për t'u ardhur në ndihmë viktimave. Kopshtet kanë detyrën t'i paraqesin si shembull opinionit publik ata persona që edhe duke rrezikuar jetën e vetë kanë dalë kundër kohës dhe kanë ruajtur vlerat njerëzore përballë ligjeve të padrejta apo indiferencës së shoqërisë. Një Njeri i Drejtë vepron sepse dëgjon thirrjen e ndërgjegjes së tij, i do të tjerët dhe bukuritë e jetës.

Në 20 vjetorin e themelimit të Universitetit ZKM u inauguroi në Tiranë Kopshti i të Drejtëve, i cili është i pari në Shqipëri. Ky kopsht ka në hapësirën e tij gurë nga zona të ndryshme të Shqipërisë, tek të cilët gdhendet emri i të Drejtë, duke treguar kështu forcën shembullore dhe bukurinë e përhershme të dëshmisë së tyre.

Përmes kësaj iniciative Fondacioni ZKM synon të promovojë mes studentëve, punonjësve dhe të ftuarve dimensionin shpirtëror të jetës, qytetarinë aktive dhe ndjeshmërinë ndaj të mirës së përbashkët. Kopshti i të Drejtëve është një hapësirë shpirtërore, takimesh dhe përkujdesjeje ndaj marrëdhënieve njerëzore.

"I drejti" i parë, emri i të cilit u gdhend në një nga gurët e Kopshtit është Carlo Urbani me motivacionin si "Mjek



i sëmundjeve infektive, i cili lajmëroi i pari në botë epideminë SARS-CoV-1 (2002-03)". Ai u prek vetë nga ky virus dhe vdiq në Bangkok më 29 mars 2003 në moshën 47 vjeçare. Ai tregoi kompetencë dhe përgjegjësi në misionet e tij humanitare pa kufij dhe duke u dedikuar tërësisht.

Kjo vepër e mbështetur fuqishëm nga Fondacioni ZKM është projektuar nga arkitektët Alfons Shtjefni dhe Claudio Radice dhe është ndërtuar nga kompania RGR. Në inaugurimin e këtij Kopshti më 6 Mars 2024 pati shumë pjesëmarrës, ndër të cilët ishin presidenti i Fondacionit ZKM, fr. Ruggero Valentini, rektori i Universitetit prof. Leonardo Palombi, nënkryetarja e Bashkisë së Tiranës, ark. Frida Pashako dhe Imzot. Arian Dodaj, Araqipeshkvi i Tiranës.

02

TË RINJ, BËNI ZHURMË!

■ Papa Françesku drejtuar studentëve

Gjatë përfundimit të vitit akademik të një universiteti, Papa mbajti online fjalën me këtë mesazh të fortë: "Mos harroni se rruga e arsimit përbëhet tre gjëra të rëndësishme: mendja, zemra dhe duart. Duhet të studiohet me mendje, duhet të ndihet me zemër dhe duhet të vepron me duar. Deri në atë pikë sa një person i arsimuar të mendojë atë që ndjen dhe bën, të ndjej atë që mendon dhe bën, të bëjë atë që ndjen dhe mendon."

Duke përfunduar, Papa më pas tha: "Vazhdoni! Bëni zhurmë në jetë, atë zhurmë që ju bën të rriteni e të ecni përpara! Zoti ju bekoftë të gjithëve. Unë lutem për ju, ju bëjeni për mua". Fjalët e Papa Françeskut janë një ftesë për të vënë studentin në qendër dhe për ta bërë atë pjesë integrale të sistemit arsimor në mënyrë që ai të ndjekë aspiratat dhe të kultivojë talentin e tij, një element thelbësor në një profesion si mjekësia, me një gjurmë të fortë vokacionale.

Të gjitha zgjedhjet profesionale kanë një motiv ideal, burimin e "vokacionit" që mbart çdo person.



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit në Aula B105 të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u mbajt një takim kushtuar vullnetarëve dhe angazhimit të tyre thelbësor për ndërtimin e komuniteteve më solidare dhe gjithëpërfshirëse. 5 Dhjetori njihet në të gjithë botën si dita e vullnetarëve dhe u caktua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.

Gjatë takimit Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini tha se kjo ditë dhe reflektimi për të është një mundësi për t’u takuar me ata që punojnë çdo ditë për të mirën e përbashkët duke dhënë mesazhin e vlerës që bart vullnetarizmi.

■ Vlerat e angazhimit qytetar

GIORNATA INTERNAZIONALE del VOLONTARIATO



MALI, ÇFARË PASIONI!

■ Prezantimi i librit “Malet e Shqipërisë” nga Piero Ghiglione

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të malit në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Aula Magna u organizua për herë të parë një takim i posaçëm nga Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë. Dita Ndërkombëtare 11 dhjetor që shënon në të gjithë botën një reflektim për pasuritë natyrore, sjell në vëmendje edhe relievin unik të Shqipërisë; një vend me dete dhe me shumë male. Në këtë takim u bënë bashkë të apasionuarit e natyrës, alpinizmit, dashamirës dhe ekspertë të mbrojtjes së mjedisit, Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini, autoritete politike dhe zbatuese, përfaqësues të Institutit Italian të Kulturës, guida profesionale të zonave malore, studentë etj.

Kjo konferencë erdhi si ide e Presidentit të FZKM fr. Ruggero Valentini, i cili iu dedikua këtij eventit edukues dhe reflektiv. Gjatë takimit u prezantua edhe një libër shumë i veçantë që rivjen për publikun shqiptar pas një periudhe të gjatë kohe.

“Malet e Shqipërisë” një botim i vitit 1941 në dy gjuhë italisht dhe shqip i autorit Piero Ghiglione u rishtyp me rastin e kësaj dite speciale ndërkombëtare.

Libri i botuar në Tiranë në vitin 1941 në italisht dhe në shqip përfaqëson një botim të çmuar për vështrimin letrar dhe frymëzues të maleve shqiptare, duke qenë në të njëjtën kohë një botim me vlera historike. Moderatorja e konferencës koordinatore Bardha Karra ftoi studentët të provojnë eksperiencën e ngjitjes në mal sepse siç ajo tha, mali është një vend që të mëson qetësinë dhe reflektimin. Në takim mes të ftuarve sollën eksperiencat e tyre mbresëlënëse Prof. Aleksandër Bojaxhi dhe Z. Fisnik Muça, guidë alpine prej shumë vitesh.



05

HENRY MARSH

■ Leksion dhe eksperiencë

Dhjetëra studentë të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” ndoqën sot në Aula Magna në kampusin universitar, leksionin e hapur të neurokirurgut të njohur britanik e me gjerë në botë Henry Marsh. Ai ndodhet në Shqipëri prej disa ditësh dhe mbajti për herë të parë një leksion të hapur me studentët që ofron më shumë dije për të rinjtë tanë të programeve të studimit të profilit mjekësor.

Profesor Marsh u prezantua në nisje të leksionit nga Dr. Mentor Petrela dhe nga Dr Anila Godo, të cilët ndoqën me interes këtë leksion të rrallë. Studentët drejtuan pyetje të shumta dhe morën përgjigje që u duartrokitën në Aula Magna, duke plotësuar njohuritë e tyre për fushën e neurokirurgjisë. Neurokirurgu i njohur edhe si shkrimtar dhe columnist për mediat më të mëdha botërore si Financial Times, The Economist, Guardian, Telegraph, Times, BBC dhe Neë York Times, është gjithashtu lektor i shquar në Universitete prestigjioze të Europës, SHBA-së, Kanadasë, Australisë dhe Azisë.

Profesor Henry Marsh është autor i trilogjisë ndër më të shiturat në botë me titujt “Mos bëj dëm”, “Pranimet”, “Dhe së fundi” të përkthyer në shqip nga Dr. Mentor Petrela dhe Florian Dashi.



Disa vite më parë neurokirurgu britanik realizoi në Tiranë një ndërhyrje kirurgjikale pioniere mbi një pacient pa narkozë, një kirurgji novatore e kryer në bashkëpunim me neurokirurgun shqiptar Mentor Petrela, një ngjarje për të cilën prestigjozja amerikane “The New York Times” i dedikoi një shkrim të posaçëm në 3 Janar të vitit 2016. Henry Marsh mban titullin mbretëror Komandant Kalorës i Perandorisë Britanike të dhënë nga Mbretëresha e ndërjerë Elisabeta e II-të.

06


DISPONUESHMËRI DHE KOMPETENCË

■ Faleminderit, Bruno!

Kur dikush largohet, trashëgimia e tij mbetet. Bruno Bosini del në pension dhe kthehet në vendlindjen e tij në Friuli (Itali).

Ai erdhi tre vjet më parë për të marrë pjesë në hapjen e spitalit të ri Zoja e Këshillit të Mirë, duke transmetuar kompetencat e tij me disponueshmëri dhe pasion. Një infermier ekspert, së bashku me fr. Natalino-n dhe Damiano-n ndanë edhe detajet më të vogla që nga dita e parë, kur spitali ishte një kuti bosh. Tani Bruno ndihet i kënaqur dhe po kërkon një pushim të merituar.

Në foto: merr nga presidenti fr. Ruggero ikonën me imazhin e shenjtorit mbrojtës të Spitalit, një dhuratë që Bruno e vlerësoi shumë.





■ Udhëtim të mbarë motër Ardiana!

Motër Ardiana përfundoi shërbimin pranë Spitalit, pasi ishte transferuar nga Komuniteti i saj fetar në destinacione të tjera. E ushtroi me një frymë bamirësie të krishterë profesionin e saj si infermiere, duke fituar respektin e të gjithëve, nga pacientët deri te mjekët dhe administratorët.


Me motrën e saj Lurden, e cila gjithashtu u largua për një mision tjetër muajt e fundi, bashkëpunoi në fazën fillestare të Spitalit të ri, duke u dhënë të sëmurëve një karakteristikë themelore të shërbimit të krishterë: empatinë e thellë. Gjatë festës së Krishtlindjes, ku morën pjesë shumica e totalit prej treqind bashkëpunëtorësh të Fondacionit, ajo u përshëndet me mirënjohje: rrugë të mbarë, motër Ardiana!

■ Së bashku për një kauzë

Universiteti dhe Spitali Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” janë bashkë çdo ditë për të eliminuar dhunën kundër grave dhe vajzave. Në ditën ndërkombëtare sollëm reflektim për rastet e shumta me pasojë humbjen e jetës dhe u bashkuam me një ndalesë të posaçme. Me këngë, lexime dhe reflektime u përpoqëm të marrim vëmendje për të zgjuar tek brezat e rinj nevojën e dialogut, të respektit ndaj tjetrit dhe mbrojtjes së grave e vajzave.

Shumë viktime kujtohen me dhimbje nga të afërmit e miqtë e tyre, por gjithashtu ato bëhen jehonë që kërkon solidaritet për të mos lejuar asnjë grua apo vajzë të bjerë pre e dhunës apo aq më keq, të humbë jetën për shkak të saj.

Ne jemi bashkë si çdo ditë në Kampusin tonë universitar për të duartrokatur me dashuri kurajon e njerëzve që ndalojnë dhunën, që e shohin respektin për jetën si mjetin e vetëm për të ndërtuar një botë më të mirë, ku dhuna nuk bën pjesë, po ku të ndryshmit janë bashkë për të mbrojtur vlerat universale.



09

ERASMUS+

■ Marrëdhëniet ndërinstitucionale

Dr. Enkeleda Gjini vizitoi Universitetin e Siënës në kuadër të programit të shkëmbimit të stafit pedagogjik të Erasmus+. Në një klasë infermierësh të ardhshëm, Dr. Gjini mbajti leksione mbi aspektet e dhimbjes, së përjetuar në kulturën shqiptare, një temë e thellë që prek jo vetëm mjekësinë, por edhe humanizmin e atyre që ofrojnë kujdes dhe atyre që e marrin atë.



Nëpërmjet një hyrjeje në kujdesin paliativ, një fokusi mbi menaxhimin e dhimbjes dhe simptomave, mbi teknikat farmakologjike dhe jofarmakologjike, mbi krijimin e planeve terapeutike të personalizuara, me një reflektim mbi komunikimin me pacientin dhe familjarët e tij, dhe sfidat etike dhe psikologjike që lidhen me fundin e jetës, të pranishmit patën mundësinë të krahasojnë praktikat italiane dhe shqiptare. Programi i shkëmbimit përtej mësimdhënies dhe shkëmbimit kulturor ishte një mundësi unike për të pasuruar aftësitë profesionale dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale midis Universiteteve tona, të gatshme për të eksploruar perspektiva të reja bashkëpunimi.

10

DIPLOMIME

■ Një hap i madh për studentët tanë

Në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u mbajtën diplomimet e Programeve të Arkitekturës, Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, Farmacisë, dhe Ekonomisë.

Kandidatët mbrojtën tezën e tyre para komisionit dhe të ftuarve.



Arkitekturë



Farmaci



Ekonomi

■ Qendra e Formimit Profesional Atë Monti

Fondacioni ZKM ka krijuar së fundmi nëpërmjet miratimit të ministrit, një degë të re formimi për të rinjtë dhe të rriturit që synojnë të kualifikohen në disa sektorë të veçantë profesionalë përmes programeve të shkurtër formuese. Nisma i përgjigjet edhe mungesës së gjerë të një personeli të trajnuar, gjithnjë e më i vështirë për t'u gjetur si në Shqipëri ashtu edhe në Evropë.

Nismat e para synojnë dy fusha: atë të kujdesit shëndetësor (për kualifikimin "Asistent social-shëndetësor") dhe atë teknik ("Programues IT").

Të dyja programet zgjasin një vit dhe realizohen



duke integruar kompetencat shqiptare dhe italiane, përmes mësimdhënies në auditorë dhe asaj online dhe përmes një praktike të konsiderueshme formimi pranë kompanive vendase dhe të huaja. Drejtori i Qendrës së



Formimit Profesional është Z. Luigj Gjergji, një drejtues me përvojë të gjerë në formimin profesional. Këto aktivitete do të kryhen në qendrat e Shkodrës dhe Elbasanit.

I shtohet në këtë mënyrë, në dyqindvjetorin e lindjes së të Lumit Luigji Monti, një mundësi e rëndësishme ofertës arsimore të Fondacionit ZKM, i njohur për veprimtarinë e Universitetit dhe Spitalit. Motivi ideal mbetet i njëjtë, sipas propozimit edukativ të Montit: "T'i bëjmë të rinjtë miq të punës".

Per info:

✉ centroprofessionale@fzkm.org

☎ +355 694028656

■ Programi GRASP u mundësua në shqip nga Dr. Suila Hasa dhe Dr. Florian Spada PhD

Programi plotësues i ushtrimeve të përsëritura dhe progresive të krahut. GRASP është një program i pavarur ushtrimesh për krahët dhe duart, që mbikëqyret nga një terapist, por kryhet nga vetë pjesëmarrësi (dhe me familjen e tij nëse është e mundur). Është vënë re se programi GRASP përmirëson funksionin dhe forcën e krahut dhe të dorës pas insulit cerebral (stroke).

Qëllimi kryesor i programit është zhvillimi i metodave të terapisë që janë të aksesueshme dhe ekonomike për të rritur numrin e sesioneve terapeutike. Në Shqipëri, sfidat aktuale përfshijnë një incidencë të lartë të pacientëve të prekur nga insulti cerebral.

Ky program ofron një përgjigje potenciale ndaj mungesave në shërbimet e rehabilitimit pas goditjes cerebrale për pacientët. Ky program ka prova të konsoliduara të efikasitetit dhe ofron burime trajnimi të disponueshme në gjuhën shqipe. Ushtrimet janë të zgjedhura për të garantuar sigurinë dhe lehtësinë e ekzekutimit, duke e bërë programin të aplikueshëm edhe në vende me burime të kufizuara. Tanimë është krijuar një komunikim me ideatorët e programit origjinal duke marrë miratimin e tyre të qartë për ofrimin e dokumenteve origjinale në format PowerPoint. Është arritur një marrëveshje për publikimin e materialeve të GRASP në gjuhën shqipe, një iniciativë e pritur mirë nga ideatorët, pasi konsiderohet një kontribut i rëndësishëm në përhapjen dhe zbatimin praktik të programit në komunitetin shqiptar.



Manualet origjinale të ushtrimeve janë në dispozicion në faqen e mëposhtme:
<http://neurorehab.med.ubc.ca/grasp/>

Takimet e ardhshme



Rimetti a noi i nostri debiti,
concedici la tua pace

GIORNATA MONDIALE DELLA PACE 2025

1 GENNAIO 2025



Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Përkushtuar Shëndetit Tënd

XXIII Giornata Mondiale del Malato

11 febbraio 2025

SANTA MESSA

**Cappella ZKM,
Tirana-Albania**
ore 8:30

Imagine in locandina:
Vetrata "Luigi Monti in preghiera per i malati"
Cappella ZKM



**ALBANIAN LANGUAGE
FOR MIGRANTS
AND REFUGEES
IN ALBANIA**



segreteria.cl@unizkm.al
+355 69 705 9292
+355 44 54 14 20

**Free
Course**

X CONGRESSO DILLE

LINGUE, TERRITORI E CONTESTI:
LE POLITICHE LINGUISTICO-EDUCATIVE OGGI

22-24 MAGGIO 2025

Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"
Tirana, Albania



La Società DILLE (Società Italiana di Didattica delle lingue e Linguistica educativa) in collaborazione con il Centro Linguistico di Ateneo dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" e la Scuola Italiana a Tirana organizzano il X Congresso dal titolo:

"Lingue, territori e contesti: le politiche linguistico-educative oggi", che si terrà a Tirana dal 22 al 24 maggio 2025.

Si invitano studiosi, ricercatori e professionisti dell'ambito linguistico a presentare i propri contributi entro il **20 gennaio 2025**, seguendo tutte le informazioni sul sito DILLE <https://www.societadille.it/>
Per ulteriori informazioni scrivere a: n.hoti@unizkm.al

Invio proposte abstract
entro il **20 gennaio 2025**



Nuovo libro

Chiedi la tua copia nella Biblioteca ZKM